
Kuota gjinore
50/50
dhe prapaskenat
e partisë A

Imprint

Botues
Fondacioni "Friedrich Ebert", Zyra e Tiranës Rr. "Kajo Karafili", Nd.14,
Hyrja 2, Kati 1 Kutia Postare 1418 Tiranë Shqipëri
info.tirana@fes.de

Departamenti i Botimeve
Departmenti IZ/ENA

Autor
Klaudja Piroli

Ilustrimet dhe dizajni grafik
Jolin Matraku
Lea Tabaku

Kontakt
Katharina Hofmann, - Drejtoreshë e FES, Zyra e Tiranës katharina.hofmann@fes.de
Jonida Smaja, - Menaxhere Programi jonida.smaja@fes.de

Botimi është mbështetur në gjetjet e studimit të mëposhtëm:

Dauti, Marsela, & Metaj, Geldona. (2025). Përvetësimi i kuotës gjinore 50/50 në këshillat bashkiakë: Prapaskenat e partive politike. Fondacioni Friedrich Ebert.

https://collections.fes.de/publikationen/id/1886237

Qëndrimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Friedrich-Ebert Stiftung e.V.(FES). Përdorimi komercial i materialeve të publikuara nga FES nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES.

Botimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Prill 2026 © Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden këtu:
www.tirana.fes.de/publikime


Friedrich Ebert Stiftung

Rrjeti i Fuqizimit të Grupeve në Shqipëri
AWEN




kuota gjinore 50/50 dhe prapaskenat e partisë A


Zgjedhjet po afrohen dhe duhet të plotësojmë kuotat gjinore 50/50.
Çfarë është kuota gjinore?!
Eeeee... mos ndoshta ka lidhje me gratë?
Po ku t'i gjejmë gratë?!
Gratë në politikë dhe gratë në timon janë problem i madh.
Duhet të kemi shumë kujdes kë vendosim në listë.
Gratë janë kudo, por ne na duhen gra të bindura.


Pse, kaq e vështirë është? Shkoni nëpër familje, tek këto fiset e mëdha. kërkoni nënat, motrat, bashkëshortet.
Unë them të mos merremi me këtë muhabet. kemi çështje më të rëndësishme për të diskutuar. Si do të justifikojmë shpenzimet për fushatën tonë? A do të hartojmë ndonjë program?
Programin e improvizojmë. Pas zgjedhjeve merremi me atë punë. kjo është çështje më e rëndësishme sepse është detyrim ligjor. Listat tona duhet të kenë 50% gra.



Nuk kemi shumë kohë. Po na mbaron afati i dorëzimit të listave.
Është urgjente.
Na duhen shumë gra.
LISTA
Atëherë dilni në qytet. kërkoni derë më derë.



NE I THEMI JO PABARAZISË NË POLITIKË
DO TË SJELLIM INOVACION DHE DO TË KRIJOJMË QYTETARË DIGJITALË
ME PARTINË TONË DO TË INTEGROHEMI NË PLANETIN MARS
NGA NJË VEND I VARFËR NË NJË SHTET DIGJITAL
ME NE DO TË JENI GJYSMË NJERËZ, GJYSMË ROBOTË
Urgjent vendosni këtë slogan në qytet: "GRATË JANË FORCË, PARAROJË E PARTISË SONË MODEL"
E ARDHMJA ME NE DO TË JETË VIRTUALE
TË GJITHË TË BARABARTË. DISA MË TË BARABARTË SE TË TJERËT
Përshëndetje, Znj.1 jemi nga Partia A.
kërkojmë gra.
Nuk të kuptoj. A mund të flasësh pak më qartë?
Mund të ma thuash edhe njëherë se për çfarë i duam gratë? Më fal, se e harrova rrugës.
Për kuotat gjinore dhe gjithëpërfshirje sepse besojmë që ju, gratë, jeni potencial për partinë tonë.
Më vjen keq, por nuk jam thjesht një numër.



Përshëndetje, Zonja 2 punëdhënësja juaj më tha se do të na bënit një nder, duke kandiduar për një mandat në këshillin bashkiak.
Jam shumë e lumtur që më konsideroni mua. A do të jetë emri im në listë të sigurt?
Po, patjetër. Ju e meritoni plotësisht, falë kontributit që keni dhënë për qytetin.
Pra, më garantoni që pozicioni im do të jetë i sigurt?
Patjetër. Vetëm firmosni sa më shpejt, se nuk kemi kohë. Boll me pyetje.
Përshëndetje, o miku im. A mund ta vendosim vajzën tuaj në krye të listës?
Patjetër. Je miku i shtëpisë sonë. Vetëm më premto se do t'i gjesh një punë të mirë. Sapo ka mbaruar studimet dhe është pa punë.
Të garantoj. kam shumë respekt për ty. Më duhet ID-ja e vajzës ose një kopje e saj. Të lutem hidh një firmë këtu në emrin e saj.
këto lista nuk mjaftojnë. Nuk i plotësojmë kuotat.
kaq gra na u përgjigjën, o shef.
Nuk na përfillin më.
Disa nuk kanë as karta identiteti.
Është bërë e vështirë. Gratë po marrin shumë zemër!
Fajin e kanë këto organizatat feministe.



Në këtë listë nuk shoh emrat e bashkëshorteve, nënave, motrave apo kushërirave tuaja. Vendosini menjëherë. S'ka nevojë t'i pyesni. Sonte, kur të shkoni në shtëpi, le të firmosin.




Përshëndetje, zonja 3. Hiq dorë nga posti, futu në listë dhe, pas zgjedhjeve, kthehu në punë.
Pse duhet ta bëj këtë? Unë jam shumë mirë në këtë pozicion.
Që të mos humbësh vendin e punës.
Oh, Zonja 4, si je?
Si jeni, Zoti A!? Si po shkon fushata?
Të lodhur pak sepse na duhen shumë gra për listat e këshillit bashkiak.
Po çfarë përfitoj unë nëse bëhem pjesë?
Lehtësira për taksat.
Po ti çfarë përfiton?
Ah, moj zemër, pushteti është i ëmbël. E di vetë ti çfarë e lezeton njeriun: leku. Disa thonë se nuk i hanë as qentë, por m'i jep mua dhe i ha me gjithë qejf.


Po si jeni, zoti biznesmen?
Mirë, mirë, shumë mirë. Nesër do të shkoj të flas me gratë në fasoneri.
Thuaju që, nëse nuk bëhen pjesë e listës, do t'i heqësh nga puna.
E dinë ato.
Zonja S, na duhen gra që janë nëna full-time. Sot veç gra beqare kam takuar dhe nuk janë fort imazh i mirë për ne.
Unë i kam pesë.
Shumë mirë, sepse na duhet të kemi në listë edhe ca gra familjare.
Po çfarë përfitoj unë?
Ushqim, veshmbathje, libra për fëmijët.


Po ndonjë punë për mua?
Ty nuk të del koha për punë, se ke pesë fëmijë. Prit të rriten edhe pak. Nuk ke pse nxiton.
PARTIA E A-VE
PARTIA E A-VE
PARTIA E A-VE
PARTIA E A-VE
PARTIA E A-VE
TVA
24
ATV
NEWS 2
A-LIVE
Përshëndetje, të nderuar teleshikues. Në këtë konferencë për shtyp, të organizuar nga vetë unë, me shumë gëzim ndaj me ju se, falë një pune shumë të madhe dhe falë besimit që kanë në partinë tonë, kemi një numër të barabartë burrash dhe grash në parti.



Festoni! Tani qyteti është i yni. Vendi gjithashtu. Sot festojmë. Nesër fillon puna. Plani i parë: më gjeni punonjës për administratën që ngjajnë me kërminjtë. këdo që ju duket si kërmill, futeni në punë. Gëzuar!
Gruaja 1.....
Gruaja 2.....
Gruaja 3.....
Gruaja 4.....
Gruaja 5.....
Gruaja 6.....
Gruaja 7.....



Lajmëroni menjëherë të gjitha gratë.
Sot duhet të dorëhiqen para marrjes së mandateve.
Dërgojini te Noteri. Le të firmosin deklaratat.
Noteri i ka gati dokumentet. Mos humbni kohë.



Po në qoftë se nuk pranojnë?



Thuajuni se do t'i largojmë nga puna. Do të binden. Shumica nuk kanë ambicie për karrierë politike.
Dhe kini kujdes. Këto biseda bëjini vetëm gojarisht. Jo në telefon. Nuk dua të mbetet asnjë gjurmë.



Po zëvendësimet i kemi gati?
Po, po. kemi shokët tanë.



Jepni dorëheqjen... Mos e diskutoni me askënd. Nëse ju pyesin pse dhatë dorëheqjen, thoni vetëm: "Për arsye familjare."
Dua të heq dorë sepse jam e zhgënjyer. Zëri im nuk dëgjohet në asnjë vend.
Do të jap dorëheqjen që t'i lë vendin burrit tim.
Po ku kam kohë për politikë, me pesë fëmijë? Por më premtuan që do t'i gjejnë një punë burrit.
E bëra për një mik të shtëpisë. Nuk më intereson politika.
I bëra nder nipit tim. Çfarë të bëjmë, detyrime familjare.
Babi më kishte vendosur në listë. Nuk e dija fare.
Po për të futur vajzën në punë, sapo ka mbaruar universitetin.
Djali më tha që kryetari i kishte kërkuar të vendoste edhe emrin tim.
Ma kërkoi si nder kushëriri i burrit.
Po, kisha dëshirë të isha në politikë, por si duket nuk paska vend për mua.
Të nderuara zonja dhe zonjusha, do të firmosni tri kopje të deklaratës noteriale për dhënien e dorëheqjes nga mandati i këshillit bashkiak. Një kopje është për ju, një për sekretarin e këshillit bashkiak dhe një për KQZ-në.
NOTERI
Për pak çaste do të jeni gra të lira.
NOTERI



Tani je një grua e lirë.
NOTERI
Ah, sikur të ishin të gjitha gratë si ty.
NOTERI
Sa mirë e ke kuptuar që ju gratë nuk keni lidhje me politikën.
NOTERI
Ty të paskan rënë në qafë kot. Me gjithë ato halle që ke, edhe politika të duhet.
NOTERI
Sa qenke plakur... Alamet vajze ke qenë.
NOTERI
Po shko, o xhan i xhaxhit, mbaro studimet pastaj merru me politikë.
NOTERI



Hajde më shpejt... tjetra... tjetra... tjetra...
NOTERI



Të dashura gra, shkoni tani në shtëpi. Kujdesuni për familjen. Rolin më të fuqishëm e keni në familje.
Nuk ka çfarë ju duhet politika.
NOTERI



Z. kryetar, u kry kjo punë. Më në fund, qyteti u lirua nga gratë. Po çjanë këto kuota gjinore, aman? kush i shpiku? Të na hipin gratë në qafë e pastaj hajde çlirohu prej tyre. Pak po durojmë ato që kemi në shtëpi.
NOTERI



PORTA E LIGJIT
MBRONI KUOTËN GJINORE NGA MANIPULIMI POLITIK.
NDALONI DORËHEQJET E KOORDINUARA TË GRAVE.
GRATË NUK JANË EMRA NË LETËR PËR TË PLOTËSUAR KUOTËN 50/50.
HETONI ÇDO DORËHEQJE MASIVE TË GRAVE KANDIDATE.
MBRONI GRATË QË RAPORTOJNË PRESION POLITIK.
JO GRA PËR LISTA. PO GRA NË VENDIMMARRJE.



keq e kemi punën. Populli qenka informuar.
kurrë s'e kisha menduar që do të dilnin në protestë për çështje të tilla.
Ore, ndoshta protestojnë për ndonjë skandal tjetër. kemi aq shumë, sa nuk i mbaj mend.
Jo, jo. Është për këtë kuotën e grave.
Shkruan "kuota gjinore" aty.
Ç'rëndësi ka? kuota e grave, kuota gjinore... njësoj janë.
A të dalim të na e sqarojnë ato aktivistet?
Oh, as nuk më intereson. Vetëm të ikin nga aty.
Deri dje mezi e shqiptonim "kuotë gjinore". As nuk e dinim çfarë ishte. Sot paskan dalë para një institucioni ligjor për të kërkuar respektimin e kuotës gjinore 50/50 në këshillat bashkiakë.
Mjaft me panik.Takoni menjëherë të gjitha gratë që dorëzuan mandatet dhe dhanë dorëheqjen nga këshillat bashkiakë. Asnjë fjalë lart e poshtë.
Po sikur Porta e ligjit të fillojë të punojë pikërisht sot?
Nuk besoj se kanë kohë të merren me çështje të tilla.
Po nëse flasin?
Gratë i japin gojës shumë.
Sa herë ju kam thënë: mos u besoni njerëzve që i kemi mësuar të heshtin.
Sa më pak dinin, aq më mirë ishim.
Edhe nëse flasin,nuk kanë asnjë provë. Hajde, mos u shqetësoni. ka edhe parti të tjera që e kanë bërë këtë. Nuk jemi të vetmit.


Te partia jonë nuk do të gjejnë asnjë shkelje të kuotës gjinore. Përqendrohuni te shkeljet e partive të tjera.
Po ne jemi partia në pushtet. E gjithë vëmendja është te ne.
Atëherë do të bëjmë atë që kërkojnë. Do ta rishikojmë ligjin për kuotën gjinore. Në zgjedhjet e ardhshme do të jemi më të kujdesshëm.
Por, fillimisht, nxirrni në dritë shkeljet e partive të tjera. Duhet ta largojnë vëmendjen nga ne.



Duhet të bëjmë gjithçka. Vetëm të mos shkelim te ajo portë e mallkuar.
Thuaju çunave dhe gocave tanë ta shpërndajnë turmën.
Çfarë metode të përdorim, shef?
E di vetë ti. Përdor metodën e zakonshme.



PËR BARAZI TË VËRTETË
Bravo, çuna. keni bërë punë të mirë.
Ajo aktivistja është prapë aty. S'paska punë tjetër.
Më thanë se ka ardhur me bukë me vete. Nuk lëviz prej aty.
Edhe pak... do t'i mbarojë ushqimi.
Më thanë se çdo ditë i lutet rojës së Portës së Ligjit t'ia marrë dosjen dhe ta shqyrtojë.
Po kush ka kohë te Porta e Ligjit të merret me këto budallallëqe?
Mirë. Vazhdojmë punën.
Po me vajzën, çfarë do të bëjmë?
Ne e kemi respektuar kuotën 50/50 në këshillat bashkiakë.
Asgjë. Një vajzë me ideale nuk është rrezik për ne.
LIGJ DREJTËSI BARAZI PËRTË GJITHË


PËR BARAZI TË VËRTETË
Të lutem... edhe sa duhet të pres?
Porta e Ligjit nuk është e hapur për të gjithë.
Të lutem, më lër të futem.
Nuk kam urdhër nga lart.
Atëherë do të pres.
PËR BARAZI TË VËRTETË



Shef, ajo është ende aty.
Do të lodhet një ditë.
Takova rojtarin. Më tha se dosja qenka shumë e rëndësishme.
Të tha çfarë ka në atë dosje?
Nuk e di, por ramë dakord t'ia marrë dosjen dhe të bëjë sikur po e çon në Departamentin e Shqyrtimit.
Hajde, sa më shpejt! M'u sos durimi.
Rri pa merak. Nuk besoj se ka ndonjë gjë shqetësuese aty brenda.


Besoj se duhet të firmos një dokument që vërteton se dosja u dorëzua.
Sapo mora urdhrin nga lart. Do ta çoj dosjen për shqyrtim.
Paske shumë pretendime. Do ma japësh dosjen apo do të vazhdosh të presësh edhe ca vite në këto shkallë?
Shef, rojtari më nisi fotografi të dosjes.
ka vetëm pesë deklarata nga gra që kanë dhënë dorëheqjen. Askund nuk shkruhet se i kemi urdhëruar ne.
Shumë mirë.
Po sikur ta kuptojnë?
Të kuptojnë çfarë? Nëse nuk shkruhet emri ynë, nuk ekziston.
Sa kohë?
Dosja u shqyrtua. Tani duhet të presësh edhe pak.
Nuk e di. Do të më njoftojnë nga lart.



Shtatë eklipse më vonë.
THE GATE OF THE LAW
Porta e Ligjit duhet të jetë gjithmonë e hapur për ne.
Duhet të heqësh dorë. Kjo portë nuk ka qenë kurrë për ty.
Më vjen keq. Studimi yt mbi kuotën gjinore 50/50 në këshillat bashkiakë dhe propozimi yt për ndryshimin e ligjit u vlerësuan si të parëndësishëm.
LAW
JUSTIC
EQUAL
FOR AL


LIVE
THE GATE OF THE LAW
DREJTËSI PËR TË GJITHË
ZËRA QË NUK NDALEN
THE GATE OF THE LAW
THE GATE OF THE LAW
E GATE OF THE LAW
kam dëgjuar se edhe tri parti të tjera janë thirrur për dorëheqjet masive të grave.
Nuk e kisha pritur kurrë që do të hyja te Porta e Ligjit për ca kuota gjinore.
Zgjedhjet po afrohen. këtë herë duhet të jemi më të kujdesshëm.
Të shohim çfarë rregullash të reja do të nxjerrin.
LAW
JUSTICE
EQUALITY
FOR ALL


Lajm i keq. Porta e ligjit nuk na la më hapësirë për manovrime në lista.
Po tani si do t'i plotësojmë listat?
Me gra.
Gra që duan të merren me politikë?
Gra që nuk japin dorëheqjen pas zgjedhjeve?
Po atëherë... na duhet të gjejmë gra me ambicie politike.
këtë vit duhet të kërkojmë ndryshe.
Tani kontrollohet çdo dorëheqje. Edhe raporti gjinor përditësohet.
Sa bezdi e kam transparencën...
Atëherë... çfarë bëjmë?
Për herë të parë... të zbatojmë ligjin.


Ore, do të më sillni ndonjë grua për të dhënë dorëheqjen?
NOTERI
Ngela pa punë!
NOTERI

FUND



kuota gjinore 50/50 dhe
prapaskenat e partisë A